



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Adresa: Rruga "Abdi Toptani" Nr.1 Tiranë;

E-mail: klsh.org.al; web-site: www.klsh.org.al

Nr. 1039/5 Prot.

Tiranë, më 21.12.2018

V E N D I M

Nr.230, Datë 21 /12/2018

PËR

AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E FONDIT KOMBËTAR
“Mbi përputhshmërinë e veprimtarisë me kuadrin rregullator në fuqi”
për periudhën nga data 01.01.2017 deri më datën 31.12.2017

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesi, Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës si dhe Drejtori i Përgjithshëm, bazuar në faktin se, në dinamikën e veprimeve të përditshme ka disa mangësi në dizenjimin e kontrollove dhe akteve administrative që rregullojnë funksionimin e Drejtorisë së Fondit Kombëtar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë si një hallkë e rëndësishme e strukturës së ngritur për miradministrimin e fondeve IPA dhe në përmbushje të rolit të saj si “thesar” i fondeve të BE dhe fondeve të bashkëfinancimit/ TVSH-së, si dhe në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr.154/2014 datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

VENDOSA

I. Të miratojë Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi Përputhshmërinë dhe Rregullshmërinë Financiare” të ushtruar në Drejtorinë e Fondit Kombëtar, sipas programit të auditimit nr. prot 1039/1, datë 17/09/2018, për veprimtarinë nga data 01.01.2017 deri më datën 31.12.2017.

II. Të miratojë rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkojë marrjen e masave sa vijon:

OPINIONI I AUDITIMIT

Ne kemi audituar përputhshmërinë e aktivitetit të Drejtorisë së Fondit Kombëtar për vitin 2017, bazuar në kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi për ngritjen e strukturave për menaxhimin e fondeve të Instrumentit për Asistencën e Para-Aderimit IPA I dhe IPA II.

Opinionin i Grupit të Auditimit mbi përputhshmërinë

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit, mbi të cilat janë formuluar gjetjet dhe rekomandimet përkatëse, si rrjedhojë e ekzekutimit të procedurave audituese, rezulton se Drejtoria e Fondit Kombëtar, përgjatë të gjitha proceseve të ekzekutimit të përgjegjësive në përmbushje të misionit të saj, i ka kryer ato në përgjithësi në përputhje me Ligjin Nr. 9840, datë 10.12.2007 “Për ratifikimin e Marrëveshjes kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe komisionit të Komuniteteve Europiane për rregullat e bashkëpunimit për asistencën për Shqipërinë, në kuadër të zbatimit të instrumentit të parazgjerimit (IPA)”; Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar si dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tyre. Ky konkluzion justifikon dhënien e një **Opinionit të pakualifikuar mbi përputhshmërinë e aktivitetit të Drejtorisë së Fondit Kombëtar për vitin 2017.**

Theksim i çështjes: *Pa ndikuar në kualifikimin e opinionit të konkluduar sa më lartë, në gjykimin e grupit të auditimit theksojmë çështjen e rolit minimal që Drejtoria e Fondit Kombëtar ka në verifikimin e kërkesave për transferim fondesh të mbërritura nga CFCU, dokumentacionin e përcjellë, kontrollet që kryhen për verifikimin e situacioneve dhe shërbimeve të faturuara dhe statusin e kontraktiveve kjo për shkak edhe të vetë mënyrës se si kjo strukturë, kompetencat dhe varësitë funksionale të saj janë konceptuar paralelisht me strukturën e CFCU-së, duke mos garantuar kështu saktësinë e raportimeve të projekteve të realizuara dhe detyrimet e lidhura me to. Gjithashtu, theksojmë dhe rolin pasiv të strukturës së ZKA/NAO, në procesin e planifikimit të fondeve të bashkëfinancimit dhe raportimit të investimeve të huaja në treguesit fiskal, çështje këto të trajtuara hollësisht në këtë raport ref. Pika 3.2;3.3 dhe 3.4. Sistemet e kontrollit mbi të cilat ato operojnë të monitorohen në mënyrë të vazhdueshme jo vetëm si një kërkesë e BE-së por dhe në përputhje me Ligjin e menaxhimit financiar dhe kontrollit nr. 10296 sipas së cilit fondet e BE janë fonde publike.*

Në e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të institucioneve supreme të auditimit (ISSAI). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin “Përgjegjësitë e audituesit për Auditimin e Përputhshmërisë” të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, në përputhje me kërkesat etike që janë të rëndësishme në auditimin e përputhshmërisë në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë Kodin e Etikës të KLSH dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Drejtimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është përgjegjës për administrimin e fondeve të BE të përthithura në kuadrin e marrëveshjeve kuadër IPA I dhe IPA II, në përputhje me Ligjin Nr. 9840, datë 10.12.2007 “Për ratifikimin e Marrëveshjes kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe komisionit të Komuniteteve Europiane për rregullat e bashkëpunimit për asistencën për Shqipërinë, në kuadër të zbatimit të instrumentit

të parazgjerimit (IPA)"; Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, si dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tyre. Drejtimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë e kryen këtë funksion nëpërmjet strukturës së ngritur posaçërisht për menaxhimin e fondeve të BE të drejtuar nga Zyrtari Kombëtar Autorizuar ZKA/NAO e mbështetur nga Drejtoria e Fondit Kombëtar dhe Drejtoria Mbështetëse.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse aktiviteti i Drejtorisë së Fondit Kombëtar nuk paraqet anomali materiale, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion mbi përputhshmërinë e aktivitetit të menaxhimit të fondeve të BE-së për vitin 2017, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Anomalitë mund të lindin nga gabimet apo mashtrimet dhe konsiderohen si materiale, nëse individualisht ose në tërësi ato influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të raportit të treguesve fiskalë të konsoliduar. Përveç standardeve të ISSAI, ne gjithashtu aplikojmë edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

Gjithashtu ne:

Identifikojmë dhe përpunojmë riskun e anomalive materiale, për shkak të gabimeve apo mashtrimeve, planifikojmë dhe kryejmë procedura auditimi sipas risqeve të identifikuara, dhe grumbullojmë evidencë të mjaftueshme e të përshtatshme për formulimin e opinionit tonë. Risku që vjen nga mos identifikimi i këtyre anomalive për shkak të mashtrimeve, është më i lartë se ai i gabimeve, sepse mashtrimi mund të përfshijë falsifikime, fshirje të qëllimshme, keqinterpretime, apo edhe mungesë të qëllimshme të kontrollit të brendshëm. Krijojmë një ide fillestare mbi kontrollin e brendshëm në mënyrë që të planifikojmë procedurat e auditimit që i përshtaten situatës aktuale, por jo duke patur si qëllim kryesor dhënien e një opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në lidhje me sistemin e thesarit.

Krijojmë një konkluzion final nëse çështjet rutine të regjistrimit, ekzekutimit dhe raportimit në sistemin e thesarit janë kryer në mënyrën e duhur dhe bazohemi në evidencën e marrë nga auditimi, për ekzistencën e ndonjë dyshimi material mbi ngjarjet apo kushtet që mund të çojnë në një dyshim edhe më të madh mbi aftësinë e institucionit për të funksionuar normalisht. Nëse ne arrijmë në konkluzionin se ekziston një pasiguri e arsyeshme, ne duhet të kushtojmë më tepër rëndësi këtyre çështjeve gjatë auditimit tonë, dhe të modifikojmë opinionin.

Konkluzionet tona janë të bazuara në punën audituese, deri në përgatitjen e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarje apo kushte specifike në të ardhmen mund të ndryshojnë situatën aktuale të institucionit. Ne komunikojmë me drejtuesin nëse, ndër çështjet e tjera, planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit dhe gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë. Gjithashtu, ne u mundësojmë drejtuesve një deklaratë në lidhje me kërkesat etike të pavarësisë sipas të cilave ne kemi kryer punën tonë audituese, dhe komunikojmë me ta në rastet kur ekziston konflikt interesi apo çështje të tjera lidhur me etikën.

Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e përputhshmërisë dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

Me ndryshimin e datës 16.01.2018 në Udhëzimin nr. 10 datë 9.3.2015 “Për përcaktimin e procedurave për menaxhimin nëpërmjet fondit kombëtar të bashkëfinancimit të buxhetit të shtetit për projektet IPA” i ndryshuar me Udhëzimin nr. 26 datë 29.12.2016, është bërë ndryshimi i pikës III. 2 si më poshtë: “*Fondet vjetore të bashkëfinancimit të palës shqiptare nga buxheti i shtetit (fondi i planifikuar në strukturën përkatëse të buxhetit vjetor në NJSHQP) transferohen nga llogaria e unifikuar e thesarit “Depozitë e qeverisë” në Bankën e Shqipërisë (TSA), në llogarinë bankare të dedikuar të Fondit Kombëtar, **brenda 15 ditësh** nga marrja e kërkesës së Fondit Kombëtar/ZKA-së drejtuar sekretarëve të përgjithshëm/zyrtarëve autorizues të NJSHQP-ve për kalimin e shumës përkatëse të bashkëfinancimit dhe TVSH-së (në rast se është e aplikueshme). Sekretari i përgjithshëm/zyrtari autorizues i NJSHQP-së, **brenda 10 ditëve** kalendarike nga marrja e kërkesës së ZKA-së, e përdor atë si dokument justifikues dhe konfirmon urdhër shpenzimit, duke ia paraqitur atë degës së thesarit për transferimin e fondit nga TSA-ja në llogarinë e dedikuar të Fondit Kombëtar, sipas procedurës ekzistuese të kryerjes së transaksioneve të qeverisjes së përgjithshme nëpërmjet sistemit të thesarit”. Ky ndryshim u iniciua nga FK për shkak të vonësive të transferimit të fondeve të TVSH nga ana e institucioneve përfituese të cilat kishin detyrimin për transferimin e këtyre fondeve te FK brenda muajit Janar. Në gjykimin e grupit të auditimit, ndryshimi me kufizim të transferimit të fondeve vetëm mbi bazën e një kërkesë dhe rast pas rasti brenda një afati 15 ditor, e bën edhe më të pamundur respektimin e afateve në kryerjen e këtyre pagesave shtuar dhe faktit që FK nuk ka dijeni nëse fondi i TVSH është disponibël apo jo për projektin në pritje për pagesë duke shtuar edhe rrezikun e aplikimit të sanksioneve për vonesa në pagesë nga ana e kontraktorëve.*

Gjithashtu, ndryshimi me Udhëzimin nr. 26 datë 29.12.2016 në lidhje me financimin e ndërmjetëm parashikon përdorimin e fondeve nga TVSH e planifikuar për projekte të cilat nuk kanë patur ecurinë e parashikuar. Megjithatë nuk është e qartë nëse një transferim i tillë është konform ligjit të Buxhetit edhe pse brenda të njëjtit program dhe nuk përcaktohet mënyra e kontabilizimit dhe raportimit të kësaj “huaje”. Për sa më sipër rekomandojmë rishikimin e menjëhershëm të Udhëzimit nr. 10, i ndryshuar, në bashkëpunim me Drejtorinë e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik dhe Drejtorinë e Kontabilitetit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Deri më 31 Mars 2019

B. MASA ORGANIZATIVE

1.-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se gjatë shqyrtimit në tërësi të kontratave të lidhura nga CFCU, në kohë dhe në vlerat përkatëse, krahasuar me limitet e përcaktuara në marrëveshjet financiare fillestare dhe të rishikuara për projektet IPA, ekzistojnë diferenca të konsiderueshme në vlerat e kontraktimit, nga të cilat lind nevoja për verifikimin e kontratave të lidhura nga CFCU me qëllim garantimin për përfundimit me sukses të projekteve të lidhura sipas marrëveshjes financiare për fondet IPA, pavarësisht vlerës së kontratave.

Më hollësisht, për IPA 2012, afati i kontraktimit për të cilën ka përfunduar, totali i vlerave të kontratave është në shumën 15,209,308 euro, nga financimi total i marrëveshjes financiare nën menaxhimin e decentralizuar në shumën 24,700,000, pra rreth 61,57%, nga ku rezulton se rreth 38% e financimit total të marrëveshjes IPA 2012 (9,490,682 Euro), ka mbetur e papërfutur nga shteti Shqiptar. Më hollësisht, një nga projektet e planifikuara, ai i ndërtimit të godinës së Gjykatës Kushtetuese, nuk ka mundur të realizohet. Për IPA 2013, afati i kontraktimit për të cilën ka përfunduar, totali i vlerave të kontratave me financim ndërkombëtar është në shumën 12,175,638 euro, nga financimi total i marrëveshjes financiare nën menaxhimin e decentralizuar në shumën 17,800,000 Euro, por për shkak të

mos kryerjes së projektit për “Ndërtimin e ndërtesës së Gjykatës”, me vlere 3,500,000 Euro, marrëveshja e rishikuar është në shumën 14,300,000 Euro, nga ku rezulton se në përfundim të periudhës së kontraktimit, janë shfrytëzuar rreth 89.9%, nga ku rezulton se rreth 10% e financimit total të marrëveshjes IPA 2013 (2,124,362 Euro), ka mbetur e papërfutuar nga shteti Shqiptar, duke mos llogaritur projektin e pa realizuar në shumën 3,500,000 Euro. Për IPA 2014, afati i kontraktimit për të cilën është data 11.12.2018, totali i vlerave të kontratave me financim ndërkombëtar është në shumën 7,873,093 euro, nga financimi total i marrëveshjes financiare nën menaxhimin e decentralizuar në shumën 17,300,000 Euro, nga ku rezulton se në limitet e fundit të periudhës së kontraktimit, janë shfrytëzuar rreth 45.5%, nga ku rezulton se rreth 54.5% e financimit total të marrëveshjes IPA 2014 (9,426,907 Euro). Për IPA 2015, afati i kontraktimit për të cilën është data 30.09.2019, totali i vlerave të kontratave me financim ndërkombëtar është në shumën 58,040 euro, nga financimi total i marrëveshjes financiare nën menaxhimin e decentralizuar në shumën 15,200,000 Euro, nga ku rezulton se në limitet e fundit të periudhës së kontraktimit, janë shfrytëzuar rreth 0.38%, nga ku rezulton se rreth 99.62% e financimit total të marrëveshjes IPA 2015 (15,141,960 Euro), në limitet e fundit.

1.1- Rekomandimi:-Zyrtari Kombëtar i Autorizuar, me strukturat e tij mbështetëse: Drejtoria e Fondit Kombëtar dhe Drejtoria Mbështetëse, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktiveve për Fondet e BE, BB dhe Donatorëve të tjerë (CFCU), nisur nga përqindja e ulët e realizimit të fondeve të BE të akorduara sipas marrëveshjeve financiare respektive të IPA I dhe II, të marri masat për kryerjen e analizave të nevojshme mbi ecurinë e procesit të kryerjes së kontraktiveve sipas projekteve të planifikuara, deri në përfundimin e tyre, me qëllim garantimin e sigurisë për kryerjen e projekteve të planifikuara, pavarësisht vlerës së kontraktimit më të ulët se niveli i marrëveshjes dhe shmangien e situatave të mos përfundimit në kohë të kontraktimit veçanërisht për IPA 2014.

Menjëherë

2.-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në kundërshtim me udhëzimin nr. 10, datë 09.03.2015, ku përcaktohet roli i Fondit Kombëtar për negocimin e vlerave përfundimtare të bashkëfinancimit për projektet IPA, procesi i planifikimit nga Ministritë e Linjës për projektet me bashkëfinancim dhe ai i CFCU drejtuar Fondit Kombëtar nuk është i dokumentuar, duke mos garantuar kështu siguri për kryerjen e rakordimeve përkatëse nga Fondi Kombëtar për konkludimin e vlerave finale. Procesi i planifikimit, në kundërshtim me udhëzimin kufizohet me shkresat në fazën PBA, që përmbajnë vlerat e planifikuara e dërguara nga ZKA për drejtuesit e institucioneve përfituese të projekteve IPA dhe në vijim procesi konkludon me një memo drejtuar Sekretares së Përgjithshme për vlerat në total të bashkëfinancimit dhe fondeve të TVSH, ku në muajin shkurt të vitit buxhetor janë dërguar njoftimet drejtuar institucioneve për transferimin e fondeve pranë Fondit Kombëtar. Nga auditimi konstatohet se në përfundimin e planifikimit buxhetor në fazën e PBA dhe atë të Buxhetit, Fondi Kombëtar nuk disponon informacionin final për vlerat e fondeve të planifikuara në buxheti nga institucionet për fondet e TVSH dhe Bashkëfinancimit në rang projekti. Gjithashtu, në fazën e rishikimit të buxhetit me Aktet Normative, nuk u konstatua asnjë rast për të cilin Fondi Kombëtar të ketë dhënë mendim për rialokim të buxhetit të planifikuar për bashkëfinancim dhe TVSH të njëjësive shpenzuese (brenda 3 ditëve nga kërkesa e MF) dhe në kundërshtim me udhëzimin nr. 7, datë 22.04.2016, pika 3 e tij, pavarësisht kësaj, Drejtoria e Buxhetit në MF ka vijuar me rialokimet.

2.1- Rekomandimi:- Fondi Kombëtar, të marrë masat për kryerjen dhe dokumentimin e plotë të procesit të planifikimit të fondeve të projekteve me bashkëfinancim nga buxheti i shtetit sipas Udhëzimit nr. 10, i ndryshuar, me qëllim negocimin e vlerave përfundimtare të bashkëfinancimit për projektet IPA dhe garantimin e një planifikimi koherent dhe të koordinuar.

2.2- Rekomandimi:- Fondi Kombëtar, si strukturë përgjegjëse për alokimin e fondeve për likuidimin e kontraktorëve të projekteve IPA, në bashkëpunim me Drejtorinë e Buxhetit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të marrë masat për asistim në procesin e rishikimit të buxhetit nga institucionet buxhetore përfituese të projekteve IPA para Akteve normative sipas Udhëzimit nr. 7 dt. 22.4.2016 pika 3 e tij, me qëllim garantimin e kryerjes së alokimeve të sakta të buxhetit sipas projekteve dhe ecurisë së tyre për shmangien e pasojave të mundshme në implementimin e projektit.

Menjëherë

3.-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se nga krahasimi i vlerave të planifikuara në fazën e PBA për institucionet buxhetore, me ato të dërguara në fund të vitit 2016 për buxhetin e vitit 2017, si dhe shkresat për transferimin e fondeve për pagesat e TVSH pranë Fondit Kombëtar ekzistojnë diferenca të konsiderueshme. Më hollësisht, në fund të vitit 2016, janë planifikuar nga Fondi Kombëtar shuma në total prej 4,552,096 Euro për pagesat e TVSH për institucionet përfituese, e reduktuar kjo vetëm 2 muaj më vonë në vlerën 2,810,165 Euro, pra rreth 1,741,931 Euro më pak, ku planifikimi në total i CFCU për pagesat e parashikuara gjatë vitit 2017 në muajin janar është 16,633,464 Euro të cilës i përket një pagesë e TVSH rreth 3,326,693 Euro. Nga auditimi konstatohet se përgjatë vitit 2017 janë kryer pagesa TVSH nga institucionet përfituese në totalin prej 224,856,043 lekë, e konvertuar në shumën 1,729,661 Euro, pra rreth 2,822,435 Euro më pak se planifikimi i Fondit Kombëtar për vitin 2017 dhe 1,080,504 Euro më pak se fondet e kërkuara nga Fondi Kombëtar për transferim në shkurt të vitit 2017.

3.1- Rekomandimi:- Fondi Kombëtar, të marrë masat për ngritjen e problematikës së rakordimit jo efikas me CFCU të ZKA dhe drejtuesit e CFCU-së, për vlerat e planifikuara për disbursim sipas statusit të kontratave të reja dhe në proces zbatimi, me qëllim shmangien e planifikimit dukshëm më të lartë se pagesat faktike i cili rezulton me djegien e fondeve të planifikuara për pagesa TVSH nga ana e njëjësive shpenzuese apo mungesë fondesh disponibël.

Menjëherë

4.-1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për vitin 2017, institucioni i **AKSHI-t** rezulton të jetë debitor për kryerjen e pagesës së TVSH për projektin “*Rishikimi i specifikimeve teknike dhe përgatitja e dosjes për kontratën e furnizimit Përmirësimi i Platformës Qeveritare të Ndërveprimit*” në vlerën 4,411.2 EURO, për të cilën deri në përfundim të periudhës së auditimit pavarësisht se me shkresën e muajit shkurt, FK ka njoftuar këtë institucion për transferimin në llogarinë e tij, shumën prej 72,000 Euro. Për këtë pagesë, konstatohet se CFCU ende nuk ka aplikuar procedura e Autongarkesës pavarësisht se ky shpenzim është kryer dhe likuiduar për pjesën IPA përgjatë vitit 2017, pasi është ende në pritje të alokimit të këtij fondi nga institucioni.

4.-2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se **Parlamenti** si institucion përfitues i projektit “*Përgatitja e specifikimeve Teknike për Aktivitetin “Furnizimi dhe Instalimi i një sistemi audio-viziv për seancat plenare të Parlamentit Shqiptar*”, i cili ka përfunduar në vitin 2016, ka rezultuar deri në fund të vitit me një detyrim të prapambetur të TVSH në vlerë 323,737.37 lekë, për kontaktorin Planet SA, i cili nuk ka qenë i regjistruar në Shqipëri në momentin e nënshkrimit të kontratës, dhe pas diskutimeve të vazhdueshme mes Parlamentit dhe Ministrisë së Financave ky institucion nuk ka pranuar të kryejë këtë pagesën përkatëse, dhe nuk rezulton më debitor në regjistrin e TVSH të Fondit Kombëtar.

4.1- 4.2-Rekomandimi:- Zyrtari Kombëtar i Autorizuar të marrë masa konkrete jo vetëm për informimin e institucioneve përfituese debitore: AKSHI dhe Parlamentin, por me qëllim garantimin e kryerjes së pagesës së TVSH të pagueshme nga ky institucion për shërbimin e përfituar sipas projektit IPA.

Menjëherë

5.-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në kundërshtim me udhëzimin nr. 10, datë 09.03.2015, pika III, 2 e tij në asnjë rast nuk është kryer transferimi i fondeve të planifikuara për pagesat e TVSh nga institucionet buxhetore në llogarinë e Fondit Kombëtar. Këto pagesa rezultojnë të jenë kryer në mënyrë të vazhdueshme gjatë vitit, dhe veçanërisht vërehen praktika e mbledhjes së faturave të pagueshme në grup dhe likuidimin e tyre duke transferuar fondet e nevojshme në muajin nëntor apo dhjetor. Më hollësisht, gjatë vitit 2017, janë transferuar në llogarinë e Fondit Kombëtar fondet në shumën 242,106,747 leke, ku janë kryer faktikisht pagesa në shumën 224,856,043 lekë, të cilat janë dukshëm më të ulëta se vlerat e kërkuara fillimisht nga Fondi Kombëtar për alokim në llogarinë e tij, duke demonstruar kështu edhe impaktin minimal që procesi i planifikimit ka tek vlerat e transferuara realisht nga institucionet.

Nga auditimi u konstatua se kryerja e pagesave të TVSH është realizuar në një kohë konsiderueshëm më të vonshme se data e faturës së kontraktorit si dhe data në të cilën është kryer likuidimi i pjesës së faturës së financuar nga fondet IPA, e cila varion nga 1 muaj më vonë deri në 1 vit pas datës së faturës së kontraktorit

5.1- Rekomandimi:- Rekomandojmë rishikimin e menjëhershëm të Udhëzimit nr. 10, i ndryshuar në bashkëpunim me Drejtorinë e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik dhe Drejtorinë e Kontabilitetit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Në vijimësi

6.1-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se nga verifikimi i pagesave për IPA 2013, në disa raste autofaturimi i pagesave për TVSH nga CFCU është kryer në një periudhë relativisht të mëvonshme nga datat e faturave të kontraktorëve të regjistruar jashtë Shqipërisë, dhe nga momenti i kryerjes së likuidimit të pjesës së financuar nga fondet IPA, në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në ligjin “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe udhëzimi nr. 6, datë 30.01.2015 në zbatim të tij.

6.2-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se kursi i këmbimit i përdorur për kryerjen e konvertimit të shumës së TVSH sipas faturës së kontraktorit të huaj, nuk ka qenë i unifikuar, duke u përdorur në disa raste kursi i këmbimit të Bankës së Shqipërisë, dhe në disa të tjera kursi INFOREURO. Gjithashtu, edhe data në të cilën është bazuar kursi i këmbimit, varion nga data e faturës origjinale të lëshuar nga kontraktori, në datën në të cilën është përgatitur fatura e autofaturuar nga CFCU, duke mos reflektuar kështu një procedurë të njëjtë të aplikueshme për të gjitha faturat.

6.3-Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i kërkesave për kryerjen e pagesave nga CFCU u konstatua se në autofaturat e TVSH të CFCU, janë vendosur edhe pagesa të shpenzimeve rastësore të kryera në Shqipëri nga kontraktorët e huaj, për të cilat pagesa e TVSH është kryer paraprakisht nga Fondi Kombëtar nga institucionet buxhetore, duke e kryer kështu dy herë përlllogaritjen e vlerës së TVSh të pagueshme nga institucioni buxhetor. Gjithashtu, shpenzimet rastësore, përfshijnë shpenzime të kryera në territorin Shqiptar ndaj subjekteve të cilat janë objekt i pagesës së TVSH (për të cilat kryhet pagesa nga institucioni përfitues) ose janë kryer në subjekte që nuk janë objekt i pagesës së TVSH, dhe nuk janë objekt i autofaturimit, pra në total shuma prej 2,119,379 lekë e paguar nga institucionet buxhetor përfitues të projekteve për shpenzime rastësore të kryera brenda Shqipërisë dhe totali prej 1,640 Euro, sipas autofaturimit të CFCU përfshin pagesën e TVSH të paguar dy herë, njëherë në momentin e detajimit të shpenzimeve se cilat janë pagesa TVSH, dhe njëherë në autofaturimin e CFCU.

6.1- Rekomandimi:- Fondi Kombëtar të adresojë problematikën e konstatuar në lidhje më periudhën e përgatitjes dhe deklarimin e faturave të autongarkesës nga ana e CFCU në kundërshtim me Ligjin për TVSH-në.

6.2- Rekomandimi:- Fondi Kombëtar në bashkëpunim me CFCU të marrë masat për përgatitjen e një udhëzimi të brendshëm të unifikuar për llogaritjen e saktë të detyrimeve të

auto-ngarkesës, azhurnimin e listave të kontrollit të kërkesave për transferim fondesh të CFCU-së, në lidhje me TVSH e aplikuar mbi shpenzimet rastësore si dhe duke përcaktuar kursin e saktë të këmbimit i cili do të përdoret.

Menjëherë

7.-1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se gjatë vitit 2017 është aplikuar procedura e financimit të ndërmjetëm për kontratën “Revision of Technical Specifications and Preperation of the Tender Dossier for the supply contract “Upgrade of the Albanian Government Gateway” për shumën 44,000 Euro nga llogaria IPA 2015 për rimbursimin e biletave hyrëse për PUPA 2016, të programuara si fonde të alokuara nga KE në llogarinë e FK për rimbursimin e biletave hyrëse të paguara nga DPD për pjesëmarrjen në programe të BE. Përdorimi i këtyre fondeve rezultoi në kundërshtim me udhëzimin nr. 26, datë 29.12.2016, pika III e tij, i cili përcakton burimet nga të cilat mund të përdoren fondet për financim afatshkurtër, ku konstatohet se përdorimi i fondeve të cilat janë transferuar nga KE për rimbursimin e institucioneve, pavarësisht faktit se këto institucione janë varësi e Ministrisë së Financave, është në kundërshtim me kriteret e këtij udhëzimi, pasi këto fonde nuk përfshihen në shpenzime korrente të MF , kosto lokale/TVSH për projektet IPA, apo fond rezervë i Buxhetit të Shtetit.

7.-2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se në kërkesën për financim të ndërmjetëm nga shpenzimet korrente të buxhetit të Ministrisë së Financës për vlerën 630,609 Euro për projektin “Ndërtimi i Ujësjellës Kanalizime Vlorë”, IPA 2012, e konvertuar kjo në 84,501,606 lekë, transferimi i këtyre fondeve nga Ministria e Financës është kryer në datën 18.12.2017 dhe shkresa për miratimin e fondeve të KE është e datës 15.12.2017, ku transferimi është kryer në datën 20.12.2017, pra dy ditë më vonë se fondet të ishin siguruar nga buxheti i shtetit, situatë kjo, që reflekton mangësitë që ekzistojnë në linjat e komunikimit mes KE dhe Fondit Kombëtar.

7.-3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se fondet e financimit të ndërmjetëm për projektin e IPA 2012, janë transferuar nga KE në llogarinë e Bankës së Shqipërisë në datën 20.12.2017, por pavarësisht kësaj transferimi i tyre në Buxhetin e Shtetit është kryer në datën 05.01.2018; gjithashtu, kthimi i fondeve të financimit të ndërmjetëm për IPA 2013, në shumën 150,000 Euro të marra gjatë vitit 2016, është kryer në datën 12.01.2017, pavarësisht se këto fonde kanë qenë disponibël nga Komisioni Europian në datën 07.12.2016, veprime këto në kundërshtim me udhëzimin nr. 26 i cili përcakton se menjëherë pas marrjes së fondeve të vonuara/munguara na BE, Fondi Kombëtar merr të gjitha masat e nevojshme për kthimin e tyre në buxhetin e shtetit.

7.1- Rekomandimi:- Zyrtari Kombëtar Autorizues në bashkëpunim me Fondin Kombëtar dhe institucionet e tjera përgjegjëse për mbarëvajtjen e procesit të miradministrimit të fondeve të BE-së si: Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe CFCU, të analizojë statusin e projektit të financuar nën IPA 2012: “Ndërtimit dhe Mbikëqyrjes së Ujësjellës Kanalizime Vlorë”, vonesat dhe problematikat në progres-raport të kërkuara nga BE, me qëllimin garantimin e disbursimit të fondeve në kohën e duhur dhe pa vonesa, duke shmangur kështu dhe përdorimin e fondeve të buxhetit të shtetit (*bridge-financing*) për të mbuluar detyrimet kontraktuale në kohë.

7.2- Rekomandimi:- Zyrtari Kombëtar Autorizues, të marrë masat për përgatitjen e një kërkesë pranë Fondit Kombëtar, për kryerjen e një kontrolli “on the spot”, pranë institucionit përfitues të projekteve të “Ndërtimit dhe Mbikëqyrjes së Ujësjellës Kanalizime Vlorë”, me qëllim garantimin e Komisionit Europian të një progres raporti i cili mbështet konkludimin e kësaj kontrate në nivele të kënaqshme.

7.3- Rekomandimi:- Zyrtari Kombëtar Autorizues, në bashkëpunim me Fondin Kombëtar, të marrin masat për aplikimin e procedurave korrekte për financimin e ndërmjetëm sipas

kritereve të akteve ligjore si dhe kthimin e menjëhershëm të këtyre fondeve në buxhetin e shtetit, pas transferimit të tyre në llogarinë e FK nga KE.

Menjëherë dhe në vijimësi

8.1-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se në kërkesën për Transferimin e Këstit të Dytë për IPA 2012 drejtuar KE, përfaqësuesit e Komisionit European kanë ngritur shqetësimin për mos pajisjen me një Raport Progresiv së bashku me dokumentet e tjera, kërkesë kjo e përcaktuar qartë në pikën 4, shënimi [1] dhe [3] i modelit të dokumentacioneve në Manualin e Procedurave. Mungesa e këtij dokumentacioni, nuk ka arritur ti sigurojë Komisionit European nivelin e duhur të sigurisë për monitorimin e vazhdueshëm të performancës operationale të projekteve në vijim sipas nivelit të kontratës, të cilat duhet të jenë të orientuara drejt rezultateve të pritshme nga kjo kontratë, dhe jo detajet e inputit dhe aktiviteteve të tjera, përgjegjësi kjo e CFCU, institucionit përfitues të projektit si dhe mos kryerjen e një verifikimi për këtë projekt nga ana e Fondit Kombëtar (pasi nuk ka patur kërkesë nga ZKA/NAO). Gjithashtu, problematikë evidentohet edhe mos pajisja me informacion dhe arsyetim për projekte të cilat nuk janë arritur të kontraktohen, tendera të pafirmosura dhe plan të rishikuar prokurimi për informacione mbi tendera të cilat priten të nënshkruhen dhe një datë e pritshme e kontratave. Mungesa e këtij dokumentacioni ka ndikuar në mos kryerjen e disbursimit të fondeve nga KE për viti 2018 për IPA 2012.

8.2-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se në kontrollin e kryera nga Fondi Kombëtar, sipas checklistës për aplikimin për fonde, të nënshkruar nga dy specialistët e menaxhimit financiar, kreu i menaxhimit financiar dhe kreu i FK, në rastet e aplikimit për fonde për para financim, modeli i parashikuar në manual i checklistës, paraqet mangësi në kërkesat përkatëse, pasi nga totali prej 49 pyetje/kërkesash, vetëm 19 prej tyre lidhen me kërkesa për parafinancim, duke mos mundësuar garantimin e sigurisë nga këto kontrole për shkak të numrit të vogël të kontroleve që lidhen me këtë lloj kërkesë.

8.3-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se në kërkesën për transferimin e këstit të dytë të parafinancimit të IPA 2013, janë parashikuar disbursime për pagesa ndaj kontraktorëve në shumën 6,114,502.32 euro, e cila duke zbritur balancën e bankës për këto fonde, e tejkalon kufirin e fondeve të financimit ndërkombëtar, i cili është sipas marrëveshjes 50% e totalit të parashikuar në marrëveshje për financim lokal, dhe në këto kushte nga KE nuk janë aprovuar fondet e kërkuara prej 3,579,588.93 Euro, por rreth 1 milion Euro më pak, pra përkatësisht 2,773,200 Euro. Parashikimi që tejkalon fondin në dispozicion për disbursime ndaj kontraktorëve, reflekton një nivel të ulët të planifikimit të drejtorisë së CFCU në bashkëpunim me Fondin Kombëtar, veprim i cili ndikon drejtpërsëdrejti në mos likuidimin e faturave të parashikuara sipas kontratave të CFCU. Gjithashtu, kjo ku edhe në check listën e kontrollit të Fondit Kombëtar për aplikim për fonde në KE, verifikimi nëse “*Sasia e kërkuar është e saktë*”, është konsideruar si e saktë nga FK, dhe nuk ka patur komente që kjo sasi e tejkalon kufirin e parafinancimit sipas marrëveshjes.

8.4-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se në kërkesat për transferimin për fonde për pjesëmarrjen në programet e BE (Entry Ticket e financuar nga KE = 80%), paketat e dërguara pranë KE, më hollësisht nën IPA 2014 dhe IPA 2015, janë të paplota, pasi nga përfaqësuesit ndërkombëtarë janë identifikuar problematika në deklaratën e shpenzimeve. Gjithashtu, për pagesat e Entry Ticket në IPA 2015, është korrektuar shuma e kërkuar paraprakisht, pasi kishte korrektime në vlerat e kërkuara për pjesëmarrje në programe, me ato të paguara faktikisht në debit note, dhe si rezultat, kjo vlerë ishte reduktuar në rreth 7,600 Euro më pak, kontrole këto që parashikohen të kryhen nga Drejtoria e Fondit Kombëtar, sipas check listës përkatëse, dhe verifikimit të dokumentacionit shoqërues, gjë që në rastin konkret nuk ka ndodhur.

8.5-Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i raporteve mujore të CFCU drejtuar Fondit Kombëtar, konstatohet se plani i disbursimeve për periudhat 12 mujore nuk korrespondon me

planin e disbursimeve të cash-it që është dërguar në kërkesat për fonde IPA pranë KE, pavarësisht se nuk ka patur ndryshim në pagesa dhe periudha e planifikimit dhe përgatitjes së tyre është e njëjtë. Mungesa e konsolidimit të të dhënave dhe kryerja e një planifikimi sa më preciz, mundëson edhe shmangien e situatave të mungesës së fondeve të cilat rezultojnë në procedura të financimit të ndërmjetëm nga ana e FK.

8.1-8.5- Rekomandimi:- Zyrtari Kombëtar Autorizues me strukturat e tij mbështetëse: Drejtorinë e Fondit Kombëtar dhe Drejtorinë Mbështetëse të ZKA të analizojnë gjithë problematikën sa më sipër në lidhje me procedurën dhe dokumentacionin shoqërues të parashikimeve dhe kërkesave respektive për fonde pranë KE si: miratimi në kohë i progres raportit për IPA2012, kontrole për parafinacimet, koordinimi i parashikimeve të CFCU me gjendjen e fondeve në përputhje me kriteret e parashikuara për limitet e disbursimeve, duke i reflektuar me kontrole shtesë në check-listat ekzistuese me qëllim shmangien e vonesave në procedimin e kërkesave nga KE.

Gjatë vitit 2019

9.1-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se kontrollet e kryera nga Drejtoria e Fondit Kombëtar në faturat e ardhura nga kontraktorët për CFCU kryhen vetëm në nivelin formati të faturës por jo përmbajtjes, duke u bazuar vetëm në verifikime të përgjithshme si data e faturës, numri i faturës, nipti i kontraktori, etj. Faturat e TVSH të ardhura nga kontraktorët nuk kanë në të bashkëlidhur situacionin përkatës, në bazë të së cilit kryhet edhe verifikimi i përlllogaritjeve për vlerën totale të detyrimit dhe si rezultat miratimi për transferimin e fondeve dhe vërtetësinë e këtyre vlerave, nga Drejtoria e Fondit Kombëtar kryhen pa kryer kontrole të mëtejshme.

9.2-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se sipas manualit të marrëveshjes, në checklistën për kontrollin e kërkesës së CFCU është përcaktuar edhe verifikimi nëse faturat janë të miratuara nga SPO, ku konkretisht, ky miratim nuk është kryer në asnjë nga faturat e TVSH për të gjithë kërkesat e vitit 2017, por vetëm për kërkesat e ardhura nga CFCU për projektin “Ndërtimi i Ujësjellës Kanalizime Vlorë”, faza 2, IPA 2012 është kryer miratimi i SPO në situacionin e pagesës së kontraktorit.

9.3-Gjetje nga auditimi: Në kërkesën nr. 13 të IPA 2012 për transferimin e fondeve dërguar nga CFCU, punonjësit e Fondit Kombëtar, kanë identifikuar një pasaktësi në shifrën e totalit të faturës së dërguar nga kontraktori, me atë të faturës me TVSH, dhe për këtë arsye kjo kërkesë është dërguar edhe njëherë punonjësve të CFCU për kryerjen e verifikimeve përkatëse dhe korigjimin e pasaktësive. Ky rast, identifikon më së miri, atë që ne kemi trajtuar më sipër, pra nevojën për dërgimin së bashku me kërkesën për fonde, edhe të situacionit të punimeve, të kontraktorit me specifikat e pagesës, dhe jo vetëm faturën me TVSH të CFCU ndaj kontraktorit.

9.4-Gjetje nga auditimi: Në kërkesën nr. 16 të IPA 2012 për transferimin e fondeve dërguar nga CFCU, fatura e TVSH për këtë projekt nuk është e firmosur nga blerësi, në këtë rast CFCU, Ministria e Financës, por përmban vetëm vulën dhe firmën e kontraktorit, por pavarësisht kësaj ajo është kaluar nga Fondi Kombëtar për disbursimin e fondeve dhe kryerjen e likuidimit të saj.

9.1-9.4-Rekomandimi:- Fondi Kombëtar, si institucion përgjegjës për kryerjen e transferimit të fondeve për pagesat e kontraktorëve në llogarinë e CFCU, të marrë masat për rishikimin e manualeve të procedurave, dhe check listave përkatëse, me qëllim përfshirjen e kontrolleve të cilat garantojnë një verifikim më të imtësishëm dhe të përqendruar në situacionet e punimeve, kryerjen e pagesave të konsulentëve, dhe kontratave përkatëse duke mos mbetur në kontrole formale të elementëve të faturës duke reflektuar kështu edhe parregullsitë e konstatuara nga kontrollet “on the spot” të vetë Fondit Kombëtar.

Gjatë vitit 2019

10.1-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, vlera e cila duhet të kalonte në zërin e “Shpenzimeve të Parapaguara” (*Biletat Hyrëse në Programet e BE për vitin 2018*) për vitin 2017, nga institucionet përfituese, duhet të ishte 119,507 mijë lekë dhe jo 222,143 mijë lekë siç është raportuar. Pas miratimit të setit të dokumentacionit të lartpërmendur ZKA i dërgon KE një kërkesë specifike për rimbursimin e kontributit IPA II. Pasi fondet janë transferuar nga ana e KE, FK transferon pjesën e rimbursimit të kontributit IPA II, sipas normave të përcaktuara në marrëveshje në institucionet përfituese përkatëse. Referuar të dhënave të marra në SIFQ, u konstatua se, për vitin 2017, ministrinë e linjës kanë paguar në **total “bileta hyrëse” në vlerën 222,143 mijë lekë**. Kjo vlerë është raportuar në mënyra të ndryshme nga ministrinë e linjës dhe përkatësisht: llogarinë 605 “shpenzime për organizatat ndërkombëtare” në vlerën 207,716 mijë lekë, në llogarinë 230,231 “investime në proces” në vlerën 14,427 mijë lekë.

10.2-Gjetje nga auditimi: Me shkresën nr. 3156, datë 14 Shkurt 2018, Drejtoria e Fondit Kombëtar i është drejtuar Komisionit Evropian në lidhje me rimbursimin e vlerës 1(një) milionë euro si kërkesë për rimbursimin e fondeve të paguar nga ministrinë e linjës përgjatë vitit 2017, fond i cili është aprovuar nga Komisioni Evropian. Referuar tabelës së mësipërme, vlera e cila do të **rimburohet përgjatë vitit 2018**, ministrive të linjës është **102,636 mijë lekë**. Si rezultat, vlera e cila duhet të kalonte në zërin e **shpenzimeve të parapaguara për vitin 2017**, është **119,507 mijë lekë (222,143 mijë-102,636 mijë)** dhe jo **222,143 mijë lekë** siç është raportuar nga ministrinë e linjës.

10.3-Gjetje nga auditimi: Përgjatë vitit 2018, Fondi Kombëtar i është drejtuar ministrive të linjës në lidhje me llogarinë kontabël e cila duhet të përdoret për rimbursimin e vlerave të Biletave Hyrëse në programe për vitin 2018, nga ku u konstatua se: nga Ministria e Drejtësisë është udhëzuar përdorimi i llogarisë **7790000 “Të ardhura të tjera”** dhe nga Ministria e Kulturës dhe Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve është udhëzuar përdorimi i llogarisë kontabël **721110000 “Të ardhura Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara”**. Konstatohet se, në lidhje me pagesat e biletave hyrëse konstatohet se, ministrinë e linjës aplikojnë llogari ekonomike të ndryshme për të njëjtën natyrë shpenzimi si në rastin e pagesave ashtu edhe të rimbursimit të shumës për të njëjtën natyrë shpenzimi.

10.1-10.3- Rekomandimi:- Ministria e Financave dhe Ekonomisë, të marrë masat për hartimin e një manuali kontabël ku të përcaktohen qartë llogaritë kontabël që duhet të preken nga institucionet përfituese të projekteve të BE dhe të Fondit Kombëtar në lidhje me planifikimin, likuidimin dhe rimbursimin e të gjitha llojeve të transaksioneve financiare që lidhen me projektet e investimeve kapitale me financim të huaj.

Menjëherë

11.1-Gjetje nga auditimi: Si rezultat i mos raportimit të saktë të realizimit të Investimeve Kapitale me Financim të Huaj pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, për shkak të mos regjistrimit në kontabilitetin e institucionit të vlerës së garancisë së punimeve të investimeve që aktualisht është një investim i realizuar si dhe keq klasifikimit të llogarisë buxhetore për vlerën e TVH-së të pa konsumuar kthyer në Buxhetin e Shtetit nga ana e Drejtorisë së FK, Investimet Kapitale me Financim të Huaj në Tabelën e Treguesve Fiskalë të Konsoliduar si dhe Të ardhurat nga Grandet për vitin buxhetor 2017 janë nënvlerësuar. Në lidhje me kërkesat për fonde për projektin “Ndërtimi i ujësjellës-kanalizime Vlorë faza II”, sipas Marrëveshjes Financiare për “Programin kombëtar për Shqipërinë nën asistencën e tranzicionit IPA dhe komponenti për nderimin institucional për 2012”/(Programi IPA 2012) nga auditimi u konstatua se, nga ana e CFCU-së kërkesa për rimbursimin e fondeve të BE, nuk përfshin vlerën e garancive të punimeve të cilat variojnë nga 3%-8% të vlerës pa TVSH për çdo faturim të kryer nga furnizuesi i punimeve. Gjithashtu konstatohet se, Drejtoria e Fondit Kombëtar, nuk kontabilizon vlerën e garancisë së punimeve si një detyrim financiar për tu likuiduar nga fondet e BE në zbatim të marrëveshjes dypalëshe ndërmjet kontraktorit

dhe CFCU dhe më pas FK për rimbursim të vlerës së investimit. Konstatohet se vlera e garancisë së punimeve të projektit “Ndërtimi i ujësjellës-kanalizime Vlorë faza IP” të mbajtur furnitorit dhe të pa regjistruar në kontabilitetin e Drejtorisë së FK, për vitin 2017, është 36,541 mijë lekë, vlerë e cila në mbyllje të periudhës ushtrimore 2017, nuk raportohet Pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit si një investim i kryer, duke ulur në këtë mënyrë më pa të drejtë realizimin e Investimeve Kapitale me Financim të Huaj.

11.2-Gjetje nga auditimi:Nga auditimi mbi Raportimin e të dhënave mbi Programin **IPA 2012**, “Asistencë tranzicioni dhe komponenti për ndërtimin e institucionit për 2012” për periudhën 01 Janar-31 Dhjetor 2017 me donator Bashkimin Evropian, lloji i financimit Grand, ku përfshihen projektet “Ndërtimi I Ujësjellës Kanalizimeve Vlorë” dhe “Supervizimi i Ndërtimit të Ujësjellës Kanalizimeve”. Konstatohet se, në çelje të periudhës ushtrimore 2017, gjendja e llogarisë bankare pranë BSH kanë qenë në vlerën 4,701,328 Euro dhe gjatë vitit 2017 për këto projekte janë disbursuar në total 5,326,595 euro dhe janë shpenzuar në total 4,701,329 euro. Në mbyllje të periudhës ushtrimore 2017 kjo llogari është mbyllur me gjendje në vlerën 5,326,549 euro. Nga auditimi u konstatua se, për vitin 2017 ***nuk është pjesë e raportimit të shpenzimeve kapitale me Financim të Huaj vlera për 630, 609 euro ose 84,601 mijë lekë*** pagesë të cilën kjo Drejtori e ka kryer ne Fonde të marra Hua (Financim afatshkurtër) nga Ministria e Financave .

11.3-Gjetje nga auditimi:Nga auditimi i të gjitha rasteve të bashkëfinancimit (TVSH e vënë në dispozicion nga buxheti i shtetit (institucionet përfitueses të projekteve) u konstatohet se,për vitin 2017, ministrinë e linjës kanë derdhur në total në llogarinë bankare të Fondit Kombëtar vlerën për **237,751 mijë lekë** për likuidimin e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) në lidhje me projektet e investimit për pjesën e Financimit të Brendshëm të mundësuar nga buxheti i shtetit për vitin 2017. Referuar të dhënave të Sistemin Informatikë të Financiar të Qeverisë (SIFQ) konstatohet se, të gjitha pagesat e kryera nga ministrinë e linjës me përfitues Fondin Kombëtar (Ministria e Financave) për “likuidimin e TVSH-së së projekteve të investimit” **është përdorur llogaria 231 “Aktive të Trupëzuara në Proces”**. Konstatohet se, për periudhën 2017, nga llogaritë bankare të Fondit Kombëtar vlera e shpenzuar për likuidimin e faturave të TVSH-së është në total për 219,417 mijë lekë. Pra vlera për **18,335 mijë lekë** (237,751 mijë lekë minus 219,417 mijë lekë) e derdhur në llogarinë bankare të Fondit Kombëtar **nuk është përdorur për likuidim e faturave të TVSH-së**. Nga verifikimi në SIFQ vlera e fondeve të pa përdorura për 17,334 mijë likuidimin e TVSH-së së projekteve e kthyer në llogarinë “Depozitë e Qeverisë” është kontabilizuar në total në llogarinë 7780100 (Të ardhura të tjera). Në këtë mënyrë vlera e investimeve kapitale është mbivlerësuar për 18,334 mijë lekë, ndërkohë që po për këtë shifër janë mbivlerësuar edhe të ardhurat.

11.4-Gjetje nga auditimi:Vlera për 1,000 mijë lekë e depozituar nga ARRSH në llogarinë e Fondit Kombëtar për pagesat e TVSH-ve të projekteve, rezulton të jetë gjendje në llogaritë bankare të Fondit Kombëtar, pra nuk është kthyer/depozituar në llogarinë “Depozitë e Qeverisë” në mbyllje të periudhës ushtrimore.

11.5-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, gjendja e llogarive bankare (Fonde të BE në Euro) për programin IPA 2015, në mbyllje të vitit ushtrimor, e raportuar nga Fondi Kombëtar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, është 5,148,694 euro krahasuar me 5,648,691.6 Euro sipas gjendjes llogarisë pra me një diferencë prej 499,997 euro më shumë. Nga verifikimi i llogarive bankare dhe kartelave kontabël kjo diferencë konstatohet se vjen nga mosraportimi pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit i arkëtimit të vlerës për 499,997 Euro të disbursimit më dt. 28.12.2017. Duke marrë në konsideratë kursin e BSH në mbyllje të periudhës ushtrimore 132.95 llogaritë vlera e pa raportuar në Tabelën e Treguesve Fiskalë të Konsoliduar për vitin 2017 në zërin të ardhura nga financimi i huaj dhe zëri “Deficiti/ Huaj/ ndryshimi i gjendjes së arkës” është nënvlerësuar me 66,474 mijë lekë ,

gjithashtu është nënvlerësuar edhe zëri “Mjete monetare në ruajtje” në vlerën 36,541 mijë lekë

11.1-11.5- Rekomandimi:- Ministria e Financës dhe Ekonomisë me strukturat e saj përgjegjëse për raportimin financiar dhe fiskal në bashkëpunim me Drejtorinë e Fondit Kombëtar të marrë të gjitha masat e nevojshme për garantimin e kryerjes së saktë të raportimit të investimeve kapitale me financim të huaj duke reflektuar konstatimet e cituara sa më sipër.

Menjëherë

12.-Gjetje nga auditimi: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Drejtoria e Fondit Kombëtar, me kërkesë të ZKA/NAO është kryer një kontroll nga kjo drejtori te Drejtoria e Prokurimeve dhe Kontraktive të projekteve me financim të huaj (CFCU) më datën 4-8.1.2018 me objekt kontrolli transkacionet e kryera gjatë vitit 2017 me qëllim certifikimin dhe vlerësimin e përputhshmërisë me kuadrin rregullator të shpenzimeve të raportuara në raportin e fundvitit 2017 (cut-off report 2017) me kriter vlerësimin e saktësisë së dokumentacionit shoqërues sipas parimit *accrual* të kontabilitetit. Konkluzionet e këtij kontrolli janë paraqitur në raportin përfundimtar të përcjellë nga ZKA/NAO më datë 22.2.2018 ku veçojmë si parregullsi të konstatuara:

-Mungesa të kontrolleve të kryera sipas listës bashkëlidhur (checklist) për çdo shpenzim për të cilin është kërkuar fondi të FK në të katër kontratat e zgjedhura për verifikim nga grupi i kontrollit, kontrata këto të lidhura me projektin IPA 2012 “Rikonstruksioni i sistemit ujësjellësit Vlorë, Faza 2”.

-Mungesë e detajimit të punimeve të kryera dhe përmbledhura në faturën/ situacionin e marrë në shqyrtim

Duke konkluduar kështu që checklist-a nuk jep një nivel të arsyeshëm sigurie për ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e dokumentave bashkëlidhur faturës/ situacionit. Gjithashtu në raport identifikohen parregullsi në mbajtjen e sistemit të kontabilitetit me pamundësi për të gjeneruar dhe ndjekur gjurmën e auditimit në nivel projekti dhe kontraktori.

Çështja e përputhshmërisë me parimin “*accrual basis*” e regjistrimit të transaksioneve nuk trajtohet në raport edhe pse është një nga pikat dhe kriteret e programit të kontrollit. Pra nuk ka evidencë për verifikimin e balancave të faturave/ situacioneve të papaguara të mbërritura në CFCU dhe në proces verifikimi apo kërkesa të miratura nga FK por të papaguara/transferuara ende te kontraktori. Në këtë këndvështrim, nisur edhe nga konstatimet e grupit të auditimit të KLSH, të shqyrtuara sa më lartë në pikën “Mbi kërkesat për fonde të shqyrtuara nga FK” në lidhje me:

- periudhën e gjatë të verifikimit të faturave/situacioneve për të cilat po kërkohen fondet nga ana e CFCU-së, nga ata e faturës deri në datën e kërkesës, e cila në disa raste shkon mbi 3 muaj, si dhe fakti se

- regjistrimet kontabël në Drejtorinë e Fondit Kombëtar bëhen mbi bazë cash-i, pra investimi raportohet i realizuar në periudhën kur transferohen fondet te CFCU,

Sa më sipër çojnë në konkluzionin e një raportimi jo koherent dhe të jo të plotë (të pasaktë) të investimeve të kryera realisht, te Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, si dhe të detyrimeve reale ndaj kontraktorëve. Ndërkohë në konkluzionin e grupit të kontrollit të FK gjetjet nuk vlerësohen si parregullsi dhe nuk kuantifikohen për të vlerësuar nëse ato janë materiale me impakt në raportimin financiar të BE dhe nuk bëhet asnjë vlerësim për saktësimin në raportimin në financat e qeverisë Shqiptare.

Në kushtet kur FK në rolin e saj si “thesar” i fondeve të BE dhe fondeve të bashkëfinancimit dhe TVSH-së por pa të drejta për të kryer pagesave te kontraktorët, misioni i saj i vetëm mbetet verifikimi i kërkesave në zbatim të parimit “four eye principle” dhe përpilimi i urdhër-transfertave. FK duhet kryhej rakordime periodike dhe jo vetëm për efekt të procedurave për përgatitjen e raporteve vjetore me qëllim bërjen të mundur të saktësimeve dhe korrigjimeve të

veprimeve rrjedhimisht të sigurimit të cilësisë së raportimit financiar vjetor cut-off te BE por edhe te Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit me qëllim raportimin periodik të treguesve fiskal dhe ecurisë së investimeve të huaja.

12.1- Rekomandimi:- Drejtoria e Fondit Kombëtar të marrë masa për rishikimin e manualit të procedurave me qëllim parashikimin e monitorimit dhe verifikimit në kontrollin e radhës te CFCU, apo në një kontroll të veçantë në varësi të rëndësisë së parregullsisë së konstatuar, të zbatimit të gjetjeve dhe rekomandimeve të rezultuara nga kontrollet e mëparshme “on the spot” si dhe dokumentimin e verifikimeve të kryera në vend apo nëpërmjet sistemit Alfa.

Gjatë vitit 2019

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R